
A woman with long brown hair, wearing a blue denim shirt, is leaning over a laptop in a bicycle repair shop. She has her hands clasped under her chin and is looking at the screen with a focused expression. The background is filled with bicycles and repair equipment, creating a professional and technical atmosphere.

**MBËSHTETJA E GRUPIT TË
BEI-SË PËR NVM-
TË NË BALLKANIN
PERËNDIMOR**



Huadhënia e BEI-së
për bizneset e vogla
dhe të mesme dhe ato me
kapital mesatar që prej
vitit 2008:

4,2 miliardë euro

BEI-ja ka siguruar financim për **28 400** shoqëri tregtare dhe
ka mbështetur mbi **500 000** vende pune në Ballkanin Perëndimor që prej vitit 2008.

PËRSE BIZNESET E VOGLA DHE TË MESME?

Bizneset e vogla janë shtylla e çdo ekonomie. Vendet e Ballkanit Perëndimor nuk bëjnë dallim. Pothuajse 99% e shoqërive tregtare në rajon janë biznese të vogla ose të mesme. Më e rëndësishmja, këto ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM) përbëjnë 72% të punësimit të përgjithshëm në rajon. Kjo është arsyeja që Banka Evropiane e Investimeve (BEI) ka investuar mbi **4,2 miliardë euro** në bizneset e vogla në Ballkanin Perëndimor që prej vitit 2008. Kjo e bën Bankën një huadhënëse ndërkombëtare udhëheqëse për NVM-të në rajon.

BEI-ja mbështet bizneset e vogla në Ballkanin Perëndimor si çelës për të nxitur rritjen ekonomike, inovacionin, integrimin social dhe krijimin e vendeve të punës. Që prej vitit 2008, investimet tona kanë mbërritur tek **28 400 shoqëri tregtare** dhe kanë ndihmuar në ruajtjen e rreth **500 000 vendeve pune** në rajon. Krijimi i vendeve të punës dhe ruajtja e vendeve ekzistuese janë me përparësi për BEI-në, pasi kjo ka rezultuar të jetë thelbësore për të ndihmuar rajonin gjatë krizës së COVID-19. **Janë ruajtur mbi 37 000 vende pune falë financimit të BEI-së.**

SI FUNKSIONON?

Grupi i BEI-së, i cili përbëhet nga Banka Evropiane e Investimeve dhe Fondi Evropian i Investimeve (FEI), ofron instrumente financimi për të ndihmuar në mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në vendet e Ballkanit Perëndimor. Grupi i BEI-së u jep kredi bankave vendore dhe ndërmjetësve të tjerë, të cilët më pas u japin kredi bizneseve të mesme dhe të vogla.

FEI-ja është e specializuar në financimin e riskut për bizneset e vogla. Ndër të tjera, ai jep garanci për ndërmjetësit me synimin e nxitjes së huadhënies ndaj firmave të vogla.

Grupi i BEI-së ndihmon NVM-të që të realizojnë plane investimi, të marrin kapital pune, të ndërtojnë ose të shtrijnë objektet e tyre të prodhimit, të përcaktojnë dhe të konsolidojnë kanalet e shpërndarjes, të kryejnë studime dhe zhvillime, e shumë më tepër. Duke punuar me institucionet financiare vendase, BEI-ja mbështet sektorin bankar në rajon përmes zhvillimit të produkteve të reja dhe rritjes së aksesit ndaj financave për shoqëritë tregtare vendase.

OFERTA JONË

Mbështetje për rimëkëmbjen nga COVID-19

Fondi Evropian i Investimeve mbështet Ballkanin Perëndimor me 1,7 miliardë euro për rimëkëmbjen nga pandemia e COVID-19, nga të cilat **400 milionë euro** synohen posaçërisht për NVM-të dhe ndërmarrjet me kapital të mesëm. Kjo paketë është pjesë e mbështetjes financiare të Team Europe për rimëkëmbjen ekonomike të rajonit.

Grupi i BEI-së ka përcaktuar një sërë masash emergjence, duke përfshirë më shumë kritere pranimiti, afate më të shkurtra dhe disbursim më të shpejtë, në përpjekje për t'ju përgjigjur më mirë dhe më shpejtë nevojave të bizneseve të vogla dhe për të mbështetur rimëkëmbjen e tyre. Për të lehtësuar ndikimin negativ të pandemisë në likuiditet dhe qëndrueshmërinë e bizneseve të vogla, BEI-ja është duke dhënë financime afat-shkurtra për të adresuar nevojat e tyre më urgjente të likuiditetit dhe për të siguruar vazhdimësinë e biznesit në sektorë të ndryshëm.

Partnerët tanë përfshijnë:

- Grupin e ProCredit në **Serbi, Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Bosnjë-Hercegovinë: 65 milionë euro** për shoqëritë tregtare në adresimin e kapitalit të tyre të punës, nevojave të likuiditetit dhe investimeve përballë pandemisë në vazhdim
- **Podgorička Banka** në Mal të Zi: Kredi në vlerën e **20 milionë eurove** për të mbështetur bizneset vendase që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorët më të prekur të ekonomisë, të tilla si shërbimet dhe tregtia me shumicë e pakicë
- **Erste Bank a.d. Novi Sad: 30 milionë euro** për të mundësuar rimëkëmbjen e bizneseve të vogla në Serbi
- **Erste Bank Montenegro:** Linjë kreditore në vlerën e **30 milionë eurove** për shoqëritë tregtare në sektorët e turizmit, prodhimit dhe shërbimeve
- **Intesa Leasing Beograd** në Serbi: **40 milionë euro** për dhënie të qirave financiare për shoqëritë tregtare vendase me kushte të favorshme dhe fleksibël
- **Raiffeisen Bank d.d.** në **Bosnjë-Hercegovinë: 12 milionë euro** për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme dhe shoqëritë e reja të prekura nga pandemia
- **Silk Road Bank AD Skopje: 5 milionë euro** për mikro-shoqëritë tregtare me një numër maksimal punonjësish prej 9 persona në Maqedoninë e Veriut

Adresimi i problemeve me të ardhurat është me rëndësi, por bizneset e vogla duhet gjithashtu që të rrisin përpjekjet për **transformimin e tyre digjital**. Fondi Evropian i Investimeve ka nënshkruar një marrëveshje me vlerë prej 60 milionë euro në Serbi, në kuadër të garancisë së Komisionit Evropian, COSME për digjitalizimin. Sipas kësaj marrëveshjeje, **Raiffeisen banka a.d. Beograd** do të jetë në gjendje që të mbështesë shoqëritë e vogla tregtare që synojnë të financojnë planet e tyre për zhvillimin e biznesit dhe transformimin digjital.

BEI-ja gjithashtu po rrit përpjekjet për të ndihmuar bizneset në sektorët e goditur më së shumti nga pandemia. Ne po japim **50 milionë euro** për **Fondin Malazet të Investimit dhe Zhvillimit** për të mbështetur bizneset e vogla që ushtrojnë aktivitetin e tyre në sektorin e turizmit dhe sektorët e tjerë të goditur më së shumti nga COVID-19. Kjo mbështetje është tepër e rëndësishme pasi të ardhurat nga turizmi tejkalojnë 20% të prodhimit të brendshëm bruto (PBB) të Malit të Zi.

Për të gjetur një listë të partnerëve tanë në vendin tuaj, vizitoni www.eib.org/intermediarieslist/.



“Shumë njerëz emigrojnë nga rajoni ynë. Por, unë vendosa të qëndroj dhe të vazhdoj të drejtoj biznesin e familjes sime. Dhe kur kishim nevojë për financim, ndërhyri Banka Evropiane e Investimeve”,
u shpreh Tomislav Puđa, pronar dhe drejtor i shoqërisë tregtare të prodhimit të produkteve të bulmetit, **Eko sir Puđa** në Bosnjë-Hercegovinë.

Financim inovativ për një treg pune gjithëpërfshirës

Mbështetja e praktikave të punësimit gjithëpërfshirës është një nga prioritetet e BEI-së në Ballkanin Perëndimor. Financimi gjithëpërfshirës i ndihmon shoqëritë tregtare të punësojnë dhe të mbajnë në punë njerëz nga grupe të cenuara të shoqërisë, të cilët shpesh hasin vështirësi për të hyrë në tregun e punës.

BEI-ja ka dhënë kredinë e parë të financimit me ndikim **(15 milionë euro)** për UniCredit Bank Srbija a.d. Për të ndihmuar bizneset e vogla vendase që të përmirësojnë **ndikimin e tyre social** në barazinë gjinore, punësimin e të rinjve dhe gjithëpërfshirjen sociale. Projekti ndërthur fondet e BEI-së me grante nga Fondi i Nismës për Qëndrueshmëri Ekonomike i BEI-së për t'u dhënë shoqërive tregtare që plotësojnë synimet e caktuara dhe që mundësojnë punësim, zhvillim profesional dhe ruajtje afat-gjatë të vendeve të punës për gratë, të rinjtë dhe grupet e tjera demografike më në nevojë dhe të cenuara, të tilla si minoritetet, personat me aftësi të kufizuara, refugjatët dhe njerëzit e zhvendosur brenda vendit.

Fondi Evropian i Investimeve ka dhënë **10 milionë euro** në garanci të mbështetura nga BE-ja për të mbështetur **punësimin e të rinjve** në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë . Garancitë do të ndihmojnë në krijimin e linjave kreditore për rreth 1 200 NVM që angazhohen në organizimin e programeve të trajnimit profesional, praktikave profesionale dhe mundësive të punësimit për të rinjtë.

Për të mbështetur bizneset e vogla në komunitetet rurale, FEI-ja dhe [Opportunity Bank Serbia](#) kanë krijuar një linjë krediti me vlerë 10 milionë euro për rreth 4 000 mikro-ndërmarrje në Serbi, të cilat nuk kanë akses të mjaftueshëm në përfitimin e shërbimeve financiare dhe që kanë nevojë për produkte kreditore për fermerët. Grupi i BEI-së do të plotësojë kreditë me edukimin e bizneseve për sipërmarrësit. Ky është transaksioni i parë në kuadër të **Programit të BE-së për Punësim dhe Inovacion Social (EaSI)** që mbështet objektivin e Bashkimit Evropian për nivel të lartë punësimi, mbrojtje të mjaftueshme sociale, luftimin e përjashtimit social dhe varfërisë, dhe përmirësimin e kushteve të punës.

* Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/99 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës



Mbështetja e praktikave të punësimit gjithëpërfshirës është një nga prioritetet e BEI-së në Ballkanin Perëndimor

Mbështetja e përbashkët e Bashkimit Evropian për bizneset vendase

Instrumenti për Sipërmarrje dhe Inovacion në Ballkanin Perëndimor (**WB EDIF**), i cili financohet nga Be-ja dhe koordinohet nga FEI-ja, përmirëson qasjen në financim për shoqëritë tregtare të vogla në Ballkanin Perëndimor. Platforma ndërthur kreditë, kapitalin, garancitë, grantet stimuluese dhe asistencë teknike për të mbështetur rritjen e NVM-ve.

Platforma ka për qëllim të përmirësojë mjedisin e biznesit për firmat e vogla dhe të promovojë kërkimin, zhvillimin e inovacionin në rajon.

BEI-ja është bankë e Bashkimit Evropian. Ne ofrojmë financim dhe ekspertizë për projekte të qëndrueshme investimesh. Në vitin 2020, Grupi i BEI-së ofroi 64 miliardë euro për investime afatgjata në të gjithë Evropën dhe në botë.

FEI-ja është pjesë e Grupit të Bankës Evropiane të Investimeve. Misioni i saj është të mbështesë bizneset mikro, të vogla dhe të mesme duke i ndihmuar në aksesimin e financimeve.

Për të gjetur një listë të partnerëve tanë në vendin tuaj, vizitoni <https://www.eib.org/intermediarieslist/>.



Banka Evropiane e Investimeve
98-100, boulevard Konrad Adenauer
L-2950 Luksemburg
☎ +352 4379-1
www.eib.org – ✉ info@eib.org

Fondi Evropian i Investimeve
37B, avenue J.F. Kennedy
L-2968 Luksemburg
☎ +352 2485-1
www.eif.org – ✉ info@eif.org

🐦 twitter.com/EIB

📘 facebook.com/EuropeanInvestmentBank

📺 youtube.com/EIBtheEUBank

Printuar në Maxioffset FSC® Mix.

BEI-ja përdor letër të certifikuar nga Këshilli i Mbikëqyrjes së Pyjeve (FSC). Sepse është bërë nga njerëz që i duan pemët. FSC-ja nxit menaxhimin e shëndoshë të pyjeve të botës në aspektin e mjedisit, me përfitime sociale dhe jetësore ekonomikisht.

Të gjithë e dimë se leximi është gjë e mirë për ju. I shërben për mirë edhe planetit – për sa kohë që lexoni në letërën e duhur.

Printuar nga Print Solutions

